

2008



QENDRA
MAQEDONASE PËR
BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR

RAPORT VJETOR

PËRMBAJTJE

Vizioni dhe misioni	3
Qëllimet dhe metodat	3
Mesazh nga udhëheqësia	4
Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë	5
Maqedonia pa diskriminim	5
Ndërmarrje të zhvilluara të vogla dhe të mesme - udhëheqja me MRFP	7
Zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rural	8
Zhvillimi lokal i bashkësive	8
Sundimi i mirë, pjesëmarrja dhe politika të drejtuara drejt njerëzve	10
Sundimi i mirë në Maqedoni	10
Shoqëri e rrënjosur dhe dinamike civile	11
Zhvillimi institucional i shoqërisë civile	11
Zhvillimi organizativ i aktorëve të shoqërisë civile	12
Diversifikim, ndërvarësi dhe dialog i pranuar kulturor	13
Bashkëpunimi ndërreligjioz në Maqedoni	13
Proces i mbështetur eurointegruar dhe bashkëpunimi rajonal	15
Udhëheqja me rrjetin ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile	15
Partneritete, marrëdhëniet me opinionin dhe mbështetje	16
Marrëdhëniet me aktorët	16
Marrëdhëniet me opinionin	16
Mbështetje - MCMS i qëndrueshëm	16
Organizata	17
Këshilli	17
Këshilli drejtues	17
Zyra ekzekutive	18
Mendim i pavarur i revizorëve	19
Raporti financiar 2008	20

Vizioni dhe misioni

Vizioni i MCMS është paqe, harmoni dhe prosperitet i njerëzve si në Maqedoni dhe në Ballkan dhe globalisht.

MCMS vizionin e vet e bazon në parimet universale të shoqërisë civile dhe demokracisë pjesëmarrëse, sundimin e të drejtës, zhvillim i barabartë dhe i qëndrueshëm socio-ekonomik, jodhuna, respekti dhe ndërvarësia dhe diversifikimi kulturor.

Misioni i MCMS është të udhëheqë dhe të ndryshojë me zgjidhje të reja dhe alternative problemet dhe sfidat shoqërore, të cilat ndikojnë te aktorët tjerë dhe të cilat inkuadrohen në rrjedhat kryesore.

Qëllimet dhe metodat

Qëllimet afatgjate të MCMS janë:

- Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë;
- Hvilim i qëndrueshëm lokal dhe rural;
- Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara nga dhe drejt njerëzve;
- Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike civile, që ndikon në politikat publike;
- Diversifikim, ndërvarësi dhe dialog i pranuar kulturor;
- Proces i mbështetur eurointegruar me bashkëpunim të forcuar rajonal;
- MCMS, organizatë e pavarur me kredibilitet, e aftë për partneritete të fuqishme dhe efektive dhe aleanca të bazuara në barazi (në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar);
- MCMS është organizatë atraktive dhe rinovuese e cila mëson, me rrënjë lokale dhe vështrim global.

MCMS aktivitetet i realizon nëpërmjet metodave programore dhe organizative:

- Metodave programore janë:
 - avokimi;
 - zhvillimi i kapaciteteve;
 - mbështetje zhvillimore dhe
 - mbështetja sociale humanitare.
- Metodave organizative janë:
 - menaxhimi dhe
 - zbatimi

Mesazh nga udhëheqësia

Edhe viti 2008 kaloi në pritjet për zhvendosjen e Maqedonisë në integrimin euro-atlantik, por kjo përsëri nuk ndodhi: u anulua pranimi në NATO për shkak të kontestit me emrin e Republikës së Maqedonisë dhe nuk u fitua data për negociata për anëtarësim në Unionin Evropian. Nga këto qëllime plotësisht na largoi edhe dhuna zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat u mbajtën në muajin qershor. Në gjysmën e parë të vitit pati rritje të madhe të bruto prodhimit të vendit, por në gjysmën e dytë, si pasojë e krizës globale, rezultatet edhe në këtë fushë u zvogëluan.

Për shkak të vëmendjes ndaj çështjeve të përmendura, duke përfshirë edhe zgjedhjet, përsëri kishte vëmendje të vogël të sektorit civil. Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me sektorin civil nuk u zhvillua me dinamikën e paraparë, ndërsa mungoi edhe mbështetja e dukshme financiare ndaj organizatave qytetare. Përmirësim është pjesëmarrja e madhe e përfaqësuesve të sektorit në organet punuese të Qeverisë për përgatitjen e ligjeve të reja. Vazhdoi trendi i zvogëlimit të mbështetjes për organizatat qytetare nga organizatat dhe fondet ndërkombëtare.

MCMS në vitin 2008 pati vëllim të përgjithshëm (portfolio) prej 47 projekteve dhe buxhet prej 75 milionë denarë. MCMS pati realizim të portfolios në kuadër të asaj që ishte planifikuar - 94% të projekteve të planifikuara, por jo edhe në raport me të ardhurat e planifikuara (66%) dhe shpenzime (65%), kryesisht për shkak të anulimit të aktiviteteve kryesore për vitin e ardhshëm në programin më të madh (financiar) (VOJ) ku merr pjesë me 31% në buxhet.

Këtë vit përfunduan programet Zhvillimi institucional i shoqërisë civile (IGO), Zhvillimi organizativ i aktorëve të shoqërisë civile (ORR) dhe Bashkëpunimi Ndërreligjioz në Maqedoni (MSM).

Në vitin 2008 vazhduan aktivitetet për ristrukturimin e MCMS me të cilin organizata duhej të akomodohet në kontekstin e ri. Këtë vit u rrumbullakua procesi i planifikimit strategjik, me miratimin e dokumenteve për Vizionin, misionin dhe qëllimet afatgjate të MCMS; Plani afarist 2008-2011, si dhe Statuti i ri i MCMS. Gjithashtu, u përfunduan zgjedhjet për përbërjen e re të Këshillit të MCMS. U vendos edhe organi i ri për udhëheqje të përditshme - Bordi drejtorëve, të cilin tani e përbëjnë dy anëtarë - drejtorë ekzekutiv.

MCMS i vazhdoi aktivitetet e veta për rritjen dhe diversifikimin e mbështetjes, duke përfshirë edhe atë financiar, për realizimin e qëllimeve. Në vitin 2008 të ardhurat nga burimet personale ishin 24% nga të ardhurat e përgjithshme ose 44% e të ardhurave për shpenzime operative.



Sasho Klekovski
Drejtor i pare ekzekutiv



Aleksandar Kërzhallovski
Drejtor ekzekutiv

Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë

MAQEDONIA PA DISKRIMINIM

Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i rrethinës mbështetëse për mundësi të barabarta të gjithë njerëzve, gjegjësisht jodiskriminimi në Maqedoni.

Këtë vit 2008, e shënuan komunikimi intensiv dhe koordinimi me partnerët në program. U organizua trajnimi për jodiskriminim për organizatat anëtare të koalicionit, për organizatat tjera të interesuara, për gazetarët dhe për përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ku morën pjesë 51 pjesëmarrës. U realizuan edhe trajnime për ndërtimin e kapacitetit të Avokatit të Popullit, Marrëdhënie me opinionin, Udhëheqje me ciklin e projektit, Menaxhment i avancuar, si dhe tryeza e rrumbullakët "Ardhmëria dhe sfidat e institucionit Avokati i Popullit". U bë zgjedhja e Sekretariatit të koalicionit, u përgatit dhe u botua Fjalori i termeve për jodiskriminim (në gjuhën maqedonase dhe shqipe) dhe u dha mbështetje për përgatitjen e Ligjit për jodiskriminim.

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi

MCMS bashkë me anëtarët tjera të lidhjes Maqedonia pa diskriminim gjatë gjithë vitit me zgjuarsi e ndiqte procesin e përgatitjes së Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Përmes dy përfaqësuesve të Lidhjes, Mirjana Najçevska dhe Zvonko Shavreski, në grupin punues në ministrinë që e përgatiste Ligjin, ishte e mundur që t'i përcjellin komentet dhe vërejtjet. Një pjesë të dispozitave kryesore për të cilat angazhohej Lidhja, për fat të keq nuk ishin pjesë e propozim Ligjit. Anëtarët e Maqedonisë pa diskriminim kërkuan nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale sqarim pse në tekstin e Ligjit nuk janë marë parasysh vërejtjet e tyre.

Lidhja e shprehu brengosjen e vet nga pasojat e jopërfshirjes së plotë të Propozimit dhe se teksti i tillë nuk është bazë e mirë për diskutime publike, nuk i ndjek standardet ndërkombëtare dhe nuk është bazë e mirë për fitimin e mendimit nga institucionet relevante ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë, pas miratimit të ligjit të këtillë përsëri do të gjendet në situatë kur qytetarët do t'i shterin të gjitha ilaçet juridike në RM dhe përsëri do t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që do të reflektohet edhe në imazhin dhe buxhetin e RM.

Lidhja edhe më tej do ta ndjek procesin e miratimit të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe do të përpiqet të kontribuojë në përmirësimin e zgjidhjeve ligjore.



Mbledhje e grupit punues të MBD për Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi

Trajnim për jodiskriminim

Njëzet përfaqësues të organizatave qytetare e kaluan trajnimin themelor dhe atë të avancuar për jodiskriminim. Pjesa më e madhe e tyre tashmë kanë punuar në teren dhe kanë dëgjuar dhe parë raste të diskriminimit në baza të ndryshme. "Trajnimi themelor, vetëm ua sqaroi disa nga punët që deri më tani i kanë ditur dhe kontribuoi për fokusimin në problematikë", tha Mirjana Najčevska, një nga trajnuesit. "Në trajnimin e avancuar hymë në atë çfarë janë kontraverze me aplikimin e Ligjit. Duke marrë parasysh atë se akoma nuk është miratuar teksti përfundimtar i ligjit ne vendosëm të shkojmë jo në atë çfarë do të thoshte aplikim konkret i ligjit por hulumtimi i rrethimit ku do të paraqitet ligji dhe si do të mund të gjendemi në këtë rrethim. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve mirë u gjendën në këtë material të ndërlikuar", shtoi ajo.

"Edhe pse programi duket i vëllimshëm, me interesim dhe vëmendje të plotë i ndjekim të gjitha sesionet, sepse janë interesante", i përcolli përshtypjet e saja Lubomir Bubevski nga Polio plus.

"Trajnimi na krijon bazë për më tutje. Tashmë filluam raste me sindikatën që e formuam, i nxitëm personat me handicap t'i kundërvihen kushteve të vështira ku punojnë. Angazhimi im në Polio plus dhe trajnimet e këtitilla më japin perspektivë tjetër për çështjen e handicapit nga ajo që e kam pasur më parë", tha Lupçoja.

"Trajnimi na mundësoi, mes tjerash, t'i dëgjojmë përvojat evropiane. Nëse i krahasojmë, mund të nxjerrim shumë nga përvojat e tyre, t'i harmonizojmë në kushtet tona dhe të mos ecim nëpër rrugën që tashmë e kemi kaluar", thotë Hajdi Shterjova-Simonoviç, këshilltare juriste në HOPS. "Trajnimi kontribuoi për kuptimin e Ligjit që duhet të miratohet, ndërsa ushtrimet që i bëmë janë shumë të rëndësishme për aplikimin e ligjit, shtoi ajo.

Përvojat evropiane pjesëmarrësve ua përcollën Katrin Vladaç nga Instituti Boltzman nga Vjena.



Pjesëmarrësit në grupe i përpunojnë rastet e diskriminimit



Përmes ushtrimeve, pjesëmarrësit testojnë si do të dukej aplikimi konkret i Ligjit

NDËRMARRJE TË ZHVILLUARA TË VOGLA DHE TË MESME - UDHËHEQJA ME MRFP

Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje, punët udhëheqëse, si dhe ato profesionale dhe administrative ia besoi Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Në vitin 2008 janë paguar 218,633,616 denarë ndaj **1,114 klientëve të ri** ose 94% nga shuma e planifikuar dhe 40% më shumë se numri i planifikuar i klientëve. Me këto kredi **u mbështetën 1,833 vende pune**, ndërsa me shfrytëzimin e kredive në drejtim të zgjerimit të veprimtarisë së tyre, këto ndërmarrje planifikojnë të punësojnë **572 punëtorë të ri**. Me këtë të fundit, numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve deri më 31.12.2008 arriti 6,322, me çka u mbështetën gjithsej 10,852 vende pune të përhershme dhe 2,301 vende të planifikuara pune.

Pjesa më e madhe e mjeteve u plasuan përmes mikro kredive ose **85%** nga kreditë e paguara në vitin 2008.

Në vitin 2008, për herë të tretë, u bë vlerësimi dhe seleksionimi i ndërmjetësuesve financiar. Për ndërmjetësues financiar për kryerjen e shërbimeve financiare të MRFP u zgjodhën: **NLB banka Tutunska, Banka IK, Kursimorja "Mozhnosti", UNI banka, Fondacioni Horizonti dhe KIB (kushtimisht).**

MRFP financiarisht i mbështeti aktivitetet e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Lidhjen e Odës Ekonomike. MRFP dhe Qendra për Zhvillimin e Bizneseve të Reja (BSC), fituan licencë për realizimin e hulumtimit më të madh në botë - **Monitorim Global i Sipërmarrjes (GEM)**, si pjesë e Ekipit nacional për GEM. MRFP për herë të tretë mori pjesë në organizimin e ngjarjes **"Dita evropiane e sipërmarrësit"** dhe për herë të dytë ishte një ndër organizatorët e **"Sipërmarrës i vitit - 2007"**.

Këshilli drejtues i MCMS zgjodhi 15 anëtarë të **Këshillit të MRFP**, i cili për herë të parë u vendos si organ më i lartë të udhëheqjes së përgjithshme dhe mbikëqyrje të MRFP. Anëtarët e Këshillit më vonë e inkuadruan edhe një anëtar.

Këshilli i kujdestarisë e zgjodhi **MCMS si Institucion për udhëheqje** për periudhën 2008-2011. Tetjana Llazarevska u emërua për drejtor ekzekutiv i MRFP.

MRFP e ruan **pavarësinë financiare prej 118%** edhe në kushte të inflacionit prej 3,3% në euro zonën. Likuiditeti i MRFP në fund të vitit 2008 ishte mbi 95% që mund të sigurojë pagesë të papenguar të kredive në muajt e parë të vitit 2009.

MRFP kremtoi 10 vjet nga ekzistimi i saj. U organizua kremtim ku morën pjesë donatorë, bashkëpunëtorë, partnerë dhe përfaqësues të sektorit afarist dhe atij shtetëror dhe ku u prezantuan arritjet, si dhe planet e ardhshme të MRFP. Për këtë qëllim u publikua edhe monografia me titull **"10 vjet MRFP"**.



Punishtja e dërrasave në Bosillovë e mbështetur nga linja kreditore e MRFP



MRFP ishte një ndër organizuesit e "Sipërmarrës i vitit"

Zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rural

ZHVILLIMI LOKAL I BASHKËSIVE

Qëllimi i programit është zhvillim nxitur lokal i bashkësive rurale dhe të margjinalizuara përmes pjesëmarrjes së rritur dhe forcimit organizativ.

Këtë vit u realizuan trajnime për: qasje te donatorët dhe përpunimi i aplikacioneve; hyrje në instrumentin për ndihmë para anëtarësimit (IPA); marrëdhëniet me opinionin; udhëheqje me resurset njerëzore; puna ekipore dhe udhëheqja e ekipit; dhe shkathtësi të komunikimit dhe zgjidhja e konflikteve, si dhe punësoria për përgatitjen e fletëparaqitjeve për mbështetje për Zhvillimin e Planeve aksionare ekologjike lokale. Në trajnimet dhe punëtoritë morën pjesë 100 pjesëmarrës.

U organizua vizitë studimi në dy komuna rurale në Slloveni, ku morën pjesë përfaqësues të BNJVL, nga komuna e Konçes, Nagoriçanit të vjetër, Karbinci, Vevçani, si dhe nga Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe Konferenca "Komunat rurale dhe mbështetja nga UE për zhvillimin rural në Maqedoni - përvojat nacionale dhe praktikat rajonale". U realizuan aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve të BNJVL dhe ADKOM. MCMS me mjete financiare e mbështeti publikimin e raporteve vjetore të 8 komunave: Tearcë, Konçe, Prilep, Çashkë, Nagoriçan i Vjetër, Mogillë dhe Veles.

U përgatit strategjia për reforma në ndërmarrjet komunale publike

MCMS dhe Banka Botërore organizuan punëtori ku rreth 100 përfaqësues të komunave, ndërmarrjeve komunale dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm biseduan

rreth problemeve me të cilat ballafaqohen dhe rekomandimet që i jep Strategjia dhe Plani aksionar. Punësoria kishte për qëllim të bëhen konsultime me të gjithë aktorët e rëndësishëm dhe të merret mendimi i tyre për rekomandimet nga Strategjia për reforma në ndërmarrjet komunale publike.

Banka Botërore me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë siguroi grant për përgatitjen e Strategjisë. Për përgatitjen e strategjisë, Banka Botërore angazhoi konzorcium nga konsulentët ndërkombëtar dhe nga vendi. Në përpunimin u inkuadrua edhe MCMS.

Kryetarët e komunave, përfaqësuesit e ndërmarrjeve komunale publike dhe aktorët tjerë biseduan për elementet e Strategjisë, për rëndësinë dhe nevojën nga një Strategji e këtillë, për atë se cila aktivitete duhet t'i ndërmarrë Qeveria, e cilat komunat, ndërmarrjet komunale publike dhe partnerët e tyre.

Pjesëmarrja e madhe në punëtorinë tregoi se sa është e rëndësishme çështja e reformave në ndërmarrjet komunale publike



Forumet në bashkësi


Në mars të vitit 2008 MCMS nënshkroi marrëveshje me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe me komunën e Karbincit për zbatimin e programit "Forumet në bashkësi". "Forumet në bashkësi" kanë për qëllim ta mbështetin pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e bashkësisë në nivel lokal. Në takimet e organizuara (forumet) qytetarët i shtronin idetë e tyre dhe merrnin pjesë në procesin e vendimit marrjes. Kjo kontribuoi që administrata komunale të jetë e hapur, më me përgjegjësi dhe më transparente. Gjatë vitit 2008 u mbajtën shtatë sesione të forumit, ku qytetarët e Karbincit patën mundësi të përgatisin projekte për përmirësimin e jetës së tyre.

"Me këto forume pritet që të përmirësohen kushtet për jetë të qytetarëve, përmes zgjidhjes së problemeve ekzistuese" - thotë Daniela Minova, bashkëpunëtore e re për marrëdhëniet me qytetarët, kompanitë dhe organizatat qytetare, në komunën e Karbincit.

Banorët e Karbincit zgjodhën tre projekte - "Teren për fëmijë", "Terrene të vogla sportive" dhe "Rregullimi urban".

"Në forumet marri pjesë që nga fillimi. Në fillim ishim pak skeptik si do të zhvillohet i gjithë procesi dhe si ne qytetarët do të mund ta bëjmë atë që e dëshirojmë. Me kohë, përmes diskutimeve dhe vizitave në teren i pamë nevojat e qytetarëve që në fund t'i përgatisim propozim projektet. Kjo ishte një përvojë e re për mua dhe për të gjithë ne. Kënaqësi e veçantë ishte se në fund të gjithë njëzëri i miratuam projektet e propozuara", na tha Marina Nikolova, mësuese nga fshati Tarinc.

Buxheti i përgjithshëm për komunën e Karbincit ka vlerën katër milion denarë, prej të cilave një milion denarë janë pjesëmarrje e komunës, ndërsa tre milionë denarë donacion i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



Banorët e komunës së Katbincit në një nga sesionet e forumeve



Sundimi i mirë, pjesëmarrja dhe politika të drejtuara drejt njerëzve

SUNDIMI I MIRË NË MAQEDONI

Qëllimi i programit është përgjegjësia e rritur e institucioneve, organizatave qytetare dhe qytetarëve.

Në vitin e parë të këtij programi të MCMS u realizuan 9 punëtori për planifikim projekti, formulim të projekteve dhe punëtori për buxhetim dhe qasje te donatorët. Punëtoritë kishin për qëllim ta ngrënë vetëdijen dhe ta forcojnë kapacitetin për përgjegjësi qytetare të liderëve lokal dhe qytetarëve nga rajonet rurale të rajonit të Kumanovës - Likovës, Shkupit dhe Tetovës.

Manastiri dhe Resnja - komunat e reja në Forumet

Më 21 tetor 2008, MCMS nënshkroi marrëveshje për realizimin e programit "Forumet në bashkësi" me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe me komunat Manastirit dhe Resnjës. Qëllimi i forumeve është të vendosen qasje participative për bashkësitë, të zhvillohen shkathtësitë dhe qëndrimet e qytetarëve dhe të vetëqeverisjes lokale për pjesëmarrje aktive në zhvillimin e bashkësisë në nivel lokal.

Manastir

Manastirasit i identifikuan problemet në komunën e tyre gjatë fundit të vitit 2008. Duke marrë parasysh propozimet më së shumti u pengon infrastruktura jo cilësore e komunikacionit, shërbimet e pakënaqura komunale dhe publike, promovimi i pamjaftueshëm turistik dhe kapacitetet e pamjaftueshme për sport dhe rikrijim. Në periudhën e ardhshme manastirasit do t'i përgatisin konceptet për projekte me të cilat do t'i zgjidhin problemet në komunë.

Resnjë

Banorët e Resnjës në numër të madh morën pjesë në sesionet e forumeve. Ata e zgjedhën mjedisin jetësor si temë ku do t'i zhvillojnë projektet. Pastaj, patën mundësi t'i caktojnë dhe të diskutojnë për problemet që mendojnë se janë prioritare për zgjidhjen nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor.



Nga sesioni i parë i forumeve në Manastir



Qytetarët e Resnjës votuan për cilën temë do të zhvillojnë projektet në sesionet e ardhshme të forumeve



Shoqëri e rrënjosur dhe dinamike civile

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i programit është krijimi i rrethinës mundësuese dhe mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë civile dhe rezultate të përmirësuara të aktorëve të shoqërisë civile në Maqedoni.

Gjatë vitit u përgatit raporti për progresin e Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil; u mbështet promovimi i punimeve të magistraturës të nëntë kandidatëve, të cilët përpunuan tema nga fusha e shoqërisë civile; për herë të tretë u realizua hulumtimi për besimin e qytetarëve në shoqërinë civile.

U promovuan publikimet hulumtuese

MCMS mbështeti botimin e 9 publikimeve hulumtuese në tema të afërta me shoqërinë civile: Liria e shprehje të mr. Slagjana Dimishkova; Sektori joqeveritar si korrigjues etik i shoqërisë të mr. Dejan Donev; Funkcionimi i Këshillit Ekonomik Social i Republikës së Maqedonisë në periudhën 1997-2000 të mr. Andon V. Majhoshev; Fillimet feministe të punës sociale të Biljana Stramshak; Organizatat qytetare në Republikën e Maqedonisë të Simonida Kacarska; Marrëdhëniet me opinionin të shoqatave të qytetarëve në Maqedoni të Marjana Ivanova; Sukses në 10 hapa - Krijimi i planit aksionar lokal për çështjen e handikapit të Afrim Iljazit; Aspektet e sigurisë njerëzore në Maqedoni - luftërat e vjetra dhe të reja të Ivana Tomovska dhe Strategjitë e mundshme për përmirësimin e punës së organizatave të shoqërisë civile përmes forcimit të brendshëm dhe profesionalizimit të sektorit - përgjigje e kërcënimeve të jashtme dhe mungesa e mjeteve për punë të sektorit nga Goran Buldioski.

Ideja kryesore ishte të motivohen të rinjtë, studentët pas diplomimit, që punimet e tyre të magistraturës të hulumtojnë tema të cilat janë në interes për shoqërinë civile. Këto publikime duhet të jenë bazë për diskutime dhe për zhvillimin e strategjive dhe planeve për zhvillimin shoqërisë civile, të bazuara në hulumtime dhe argumente, si dhe të promovojë emra të ri, ekspertë të ri në shoqërinë civile.

Mbështetja e MCMS ishte në formë të grantit të cilin mund ta shfrytëzonin për shpenzime hulumtuese dhe për botimin e hulumtimeve. Shuma e përgjithshme kishte vlerën prej 730,000 denarë.

Në promovimin e parë u prezantuan tre nga publikimet hulumtuese



ZHVILLIMI ORGANIZATIV I AKTORËVE TË SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i programit janë kapacitete të zhvilluara organizative dhe institucionale të organizatave qytetare dhe aktorëve tjerë të shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2008 u realizuan 36 konsultime dhe trajnime ku morën pjesë 520 përfaqësues të organizatave qytetare, sektori shtetëror dhe afarist, bashkësive fetare, mediave etj.

Doracak për menaxhim me resurset njerëzore

Doracaku Menaxhim i resurseve njerëzore është përmbledhje e aspekteve teorike dhe praktike të udhëheqjes dhe zhvillimit të njerëzve në një organizatë dhe ofron vegla të cilat aplikohen gjatë këtyre proceseve. Pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për të punësuar ose vullnetarë, nevojitet të përmendet se organizatat qytetare mobilizojnë kapital të rëndësishëm njerëzor për të cilin duhet të kujdesen në mënyrë adekuate që të zhvillohet dhe të motivojë. Për këtë qëllim është e nevojshme të respektohen konceptet themelore për Menaxhimi me resurset njerëzore të cilat janë të vlefshme për çdo organizatë. Kështu, është e nevojshme të kihet kujdes që të angazhohen njerëzit e vërtetë në vendin e vërtetë, t'u mundësohet të akomodohen në organizatë, ndaj sistemeve, procedurave, vlerave dhe kulturës, t'u jepet mundësi që të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të eja, puna e tyre të vlerësohet dhe të vlerësohet në mënyrë fer, të vendosen sisteme të vërteta të cilat do të mundësojnë ata të motivohen dhe të kënaqen në punën e tyre dhe në fund t'u mundësohet të "rriten" dhe ta "mbikalojnë" organizatën që të jenë miq të saj dhe të llobojnë në vende dhe pozita të tjera. Doracaku është përgatitur për nevojat e projektit programi për ndërtimin e kapaciteteve 2008 dhe është dedikuar për organizatat partnere të OSBE dhe organizatave tjera qytetare.

Planifikimi strategjik

Si të përgatitet plan i suksesshëm strategjik, ishte sfidë e vërtetë për 13 pjesëmarrësit e trajnimit Strategjia për sukses që u mbajt në muajin qershor në Ohër.

Pjesëmarrësit patën mundësi të njoftohen me parimet themelore të një organizate, me fazat e saja të zhvillimit dhe vendosjen institucionale. Dëgjuan për modelin e integruar organizativ (IOM), si dhe për aplikimin e konceptit të zhvillimit institucional dhe forcimit organizativ. U njoftuan me analizën e problemeve, bënë SWOT analizë, mësuuan për planifikimin e orientuar strategjik (SOR), u njoftuan edhe me konceptin e kornizës logjike dhe për elementet tjera lidhur me planifikimin strategjik.

Edhe pse gjithë trajnimin e konsiderojnë si të dobishëm, më së shumti i veçuan SWOT analizën dhe SOR matricën, pastaj drurin e problemeve dhe kornizën logjike. Pjesëmarrësit vlerësuan se qëllimet e trajnimit u plotësuan, ndërsa për vetë trajnimin thanë se është shumë i dobishëm. Ata që ishin më aktiv në fund të trajnimit kishin plan se si do ti aplikojnë njohuritë e fituara.



Përveç teorisë, pjesëmarrësit edhe praktikisht i aplikuan veglat për planifikim strategjik



Disa nga pjesëmarrësit në fund të trajnimit kishin plan se si do ti aplikojnë njohuritë

Diversifikim, ndërvarësi dhe dialog i pranuar kulturor

BASHKËPUNIMI NDËRRELIGJIOZ NË MAQEDONI

Qëllimi i programit është rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë mes bashkësive fetare dhe mirëkuptimi për ato te opinioni maqedonas në përgjithësi.

Grupi qëllimor janë anëtarët e bashkësive fetare në Maqedoni, me fokus të studentëve (dhe profesorëve) të institucioneve arsimore (fakultetet teologjike dhe pjesërisht shkollat e mesme) të bashkësive fetare.

Përmes aktiviteteve të ndryshme (ligjërata shkëmbimi, vizita objekteve fetare, shkollave teologjike), anëtarët e bashkësive fetare dhe studentët e teologjisë kishin mundësi të njoftohen me religjionin, kulturën dhe traditën e të tjerëve, si dhe të vendosin kontakte të ndërsjella. Në kuadër të programit në këtë periudhë u realizuan pesë ligjërata shkëmbimi, një vizitë në një shkollë teologjike, tre vizita objekteve fetare, dhe u mbështet Zyra për bashkëpunim me bashkësitë fetare. MCMS gjithashtu e mbështeti edhe organizimin e konferencës së Grupit Evropian Rajonal për Partneritet (ERPG) të Këshillit Botëror të Kishave (KBK). Nga botimet informative u botuan dy buletin për bashkëpunim ndërreligjioz dhe Adresari i bashkësive fetare. Nga fundi i vitit u realizua edhe vizitë studimi në Jerusalem, që ishte edhe aktiviteti i fundit në kuadër të programit.

Rrethi i prindërve (Parents Circle)

Kjo është organizatë e prindërve, të cilët kanë humbur fëmijën e tyre gjatë konfliktit. Anëtarët e kësaj organizate janë izraelitë dhe palestinezë dhe siç thonë edhe vetë ata ky është grupi i vetëm i cili nuk do të ketë edhe një anëtar tjetër.

Këta prindër takohen mes veti dhe bisedojnë për humbjen e tyre, pa marrë parasysh kombin. Ata për vete thonë se janë si vëllezër. Angazhohen për paqe dhe pajtim që të mos përsëritet ajo që u ka ngjarë atyre.



Pjesëmarrësit në vizitën e studimit me izraelitët Rami Elhanan dhe palestinezin Basam Aramin, prindër të fëmijëve që kanë pësuar në përleshjet e armatosura të dy palëve

Vizita e studimit në qytetin e shenjtë të Jerusalemit u realizua në tetor të vitit 2008. Përmes vizitës bëheshin përpjekje të kontribuohet drejt ruajtjes së paqes dhe ndalimit të konflikteve, përmes njoftimit, shkëmbimit të mendimeve me vendet tjera. Delegacioni maqedonas përbëhej prej 16 përfaqësuesve (anëtarë të bashkësive fetare, Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe përfaqësues nga MCMS). Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ishte përgjegjëse për ngjarjen, ndërsa organizator nikoqir i ngjarjes ishte Jerusalem Interchurch Center (JIC).

Vizita pjesëmarrësve u mundësoi të njoftohen me konfliktin izraelito-palestinez, rolin e organizatave qytetare lidhur me parandalimin e konfliktit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rolin dhe shkallën e angazhimit të bashkësive fetare lidhur me paqen dhe pajtimin etj. Pjesëmarrësit vizituan më shumë institucione mes të cilave: United Nations Office of Humanitarian Affairs, Swedish Christian Study Center (në këtë qendër u organizua njoftimi i pjesëmarrësve me mbrojtjen e të drejtave të njeriut: Breaking the silence, Rabbies For Peace i B'etsleem), Tantur Ecumenical Institute (ku u njoftuan me anëtarët e organizatës Rrethi i prindërve ose Parents circle) etj. Krahas vizitave të organizatave u realizuan edhe takime me përfaqësues të organit të porsaformuar Council of "Religious Institutions" of the Holy Land, ndërsa pjesëmarrësit patën mundësi të vizitojnë objekte të rëndësishme fetare në qytetin e shenjtë.

Thyerja e heshtjes (Breaking the Silence)

Kjo është organizatë e ish luftëtarëve izraelit të cilët e kanë kryer shërbimin ushtarak në terrioret e okupuara gjatë Intifadës së dytë. Ata janë dëshmitarë ose kanë arrë pjesë në aksione ushtarake, të cilat i kanë ndryshuar edhe ata vetë. Ata përkujtohen në raste të keqtrajtimit të palestinezëve, vjedhje dhe shkatërrim të pronës së tyre, të cilat janë kryer me vite të tëra, e akoma sqarohen si domosdoshmëri lufte, ose raste ekstreme ose unikate.

Organizata angazhohet që ta njoftojë opinionin izraelit mes shkrimeve dhe botimin e dëshmive të ish luftëtarëve izraelit për veprimet e tyre në terrioret e okupuara. Edhe pse territori i okupuar është vetëm 10 minuta larg Jerusalemit, popullata izraelite nuk shkon atje dhe nuk e di si është gjendja.



Takim në Swedish Christian Study Center me përfaqësuesit e organizatës Breaking the silence, Rabbies For Peace dhe B'etsleem.

Proces i mbështetur eurointegruës dhe bashkëpunimi rajonal

UDHËHEQJA ME RRJETIN BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Rrjetin ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile (BCSDN) e përbëjnë 14 organizata qytetare nga dhjetë vende të rajonit të Ballkanit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Mali i Zi, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Rumania, Sllovenia dhe Serbia.

Edhe këtë vit vazhduan aktivitetet për azhurnimin e ueb faqes me lajme dyjavëshe; u organizuan mbledhje koordinatave; u vëzhgua zbatimi i regjimit të lehtësuar të vizave; dhe filloi hulumtimi për rolin e shoqërisë civile në procesin e eurointegritimeve.

Vëzhgimi i lehtësimit të vizave në Maqedoni

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar në partneritet me katër organizata nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia dhe ECAS nga Brukseli e zbatuan projektin për vëzhgimin e realizimit të Marrëveshjes për regjim të lehtësuar të vizave në vendet e Ballkanit Perëndimor.

U realizuan 774 anketa të parashtruesve për viza, ndërsa në info linjën për qytetarët u pranuan dhe u regjistruan 105 thirrje.

Raporti konstatoi më shumë probleme në zbatimin e marrëveshjes për regjim të lehtësuar të vizave si për shembull: mungesa e sqarimit për refuzimin e kërkesës për vizë; problemi me dokumentet e nevojshme dhe kërkesa për dokumente plotësuese; procesi i dhënies të vizave është më i gjatë nga ai që thuhet; nuk ka qasje të lirë dhe pa pagesë deri te viza; ka probleme me trajtimin e ashpër dhe johuman nga ana e personelit në ambasada.

„Udhëtimi i panevojshëm”

Ky është rrëfimi i një çifti nga Kumanova i cili planifikonte ta vizitonte djalin, vajtën dhe mbesën e tyre në Gjermani. Ata parashtruan kërkesë për vizë më 19 shkurt. Letra garantuese ka qenë e siguruar nga fëmijët e tyre që punojnë dhe jetojnë në Gjermani me vite të tëra. Personi ka sqaruar se është i punësuar dhe është në mundësi të sigurojë dëshmi për këtë për nevojat e ambasadës. Kërkesa e tyre për vizë është mbajtur shtatë ditë dhe janë informuar se janë refuzuar. Edhe krahas kërkesës për sqarim për shkaqet e refuzimit, nuk u janë dhënë informata dhe janë larguar me fjalët: “ky udhëtim është i panevojshëm dhe çfarë kërkon atje”. Bashkëshorti për herë të dytë parashtron kërkesë për vizë, dhe pasi që nuk merr sqarim pse është refuzuar është demoralizuar që të aplikojë përsëri.



Fillimi i vëzhgimit të lehtësimit të vizave u paralajmërua me pres konferencë

Marrëdhëniet me aktorët

Bashkëpunimi i MCMS u zhvillua me organizata dhe institucione nga vendi, agjenci anëtare të Këshillit Botëror të Kishave (WCC) dhe me organizata të tjera të huaja.

Në fillim të vitit u realizua vlerësimi i programit për punë të Platformës Qytetare të Maqedonisë (GPM) për periudhën 2006-2007. Aleksandar Kërzhallovski u zgjodh nga anëtarët e GPM si përfaqësues në Këshillin Nacional për Integritet Evropian. MCMS është një nga iniciatorët e Koalicionit Maqedonia pa diskriminim. MCMS në mënyrë aktive mori pjesë në përgatitjen e propozim-statutit të koalicionit. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe me institucionet shtetërore ishte në nivelin e zakonshëm.

Bashkëpunimin rajonal MCMS para së gjithash e realizon mes Rrjetit ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile, themelues i së cilës është ajo. Bashkëpunimi me Delegacionin e Komisionit Evropian dhe në përgjithësi me Komisionin Evropian në vitin 2008 u realizua përmes shumë aktiviteteve, si konsultimet rajonale për Planin Shumëvjeçar Indikativ (MIPD) për periudhën 2009-2011, si dhe pjesëmarrja në konferencën e KE për bashkëpunim me shoqërinë civile. MCMS rregullisht merr pjesë në Kuvendin Botëror të CIVIKUS.

MCMS është anëtare e:



ECOSOC



ACT
International



CIVICUS



Rrjeti Ballkanik
për Zhvillimin e
Shoqërisë Civile



PLATFORMA
QYTETARE E
MAQEDONISË

Marrëdhëniet me opinionin

MCMS këtë vit për herë të tretë i organizoi Ditët e hapura të MCMS. Ditët e hapura u organizuan nga 20 deri më 26 maj 2008 dhe u organizuan në Tetovë, Manastir dhe Veles. Ditët e hapura i vizituan 40 qytetarë.

Raporti vjetor i MCMS u botua në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Gjatë vitit 2008 u realizuan 147 paraqitje në mediat.

Mbështetje - MCMS i qëndrueshëm



Logoja nën të cilën u realizua fushata "Dhuro nga tatimi yt"

MCMS këtë vit e realizoi projektin "Promovimi i nxitjeve tatimore për personat fizik", ku përmes fushatës mediave në gazetat ditore dhe javore qytetarët u informuan për mundësinë që të dhurojnë një pjesë të tatimit të ardhurave të tyre personale për projekte të organizatave qytetare.

U testuan më shumë mekanizma për dhurim, siç është dhurimi përmes telefonit. Gjithashtu u ndërmorën edhe aktivitete për forcimin e vetëdijes rreth çështjeve të integriteteve euroatlantike të Maqedonisë, përmes mini fushatës "Edhe Maqedoni edhe NATO".

Duke u treguar si ofrues cilësor i shërbimeve konsultuese për ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimi me OSBE u zgjerua edhe në shumë aktivitete si rregullorja ligjore për jodiskriminim dhe forcimi i kapaciteteve të bashkësive lokale.

Në vitin 2008 MCMS parashtrroi 38 aplikacione deri te 15 donatorë/furnizues të shërbimeve. Prej tyre 12 janë miratuar/pranuar, 23 janë refuzuar dhe 3 janë në proces të vendosjes.

:: ORGANIZATA ::

Në fund të vitit 2008 MCMS e shënoi 15 vjetorin e ekzistimit dhe punës të vet. Në 15 vitet e kaluara MCMS realizoi 1.481 projekte në 60 programe, me buxhet të përgjithshëm prej rreth 46 milionë e 400 mijë euro.

:: KËSHILLI ::

Këshilli i miratoi dokumentet e reja strategjike të MCMS: Vizioni, misioni dhe strategjia e MCMS dhe Plani afatmesëm për punë 2008-2011. Gjithashtu u vërtetua edhe Statuti i ri i MCMS dhe u zgjodh përbërja e re e Këshillit.

Natasha Gaber - Damjanovska
Abdurauf Pruthi
Aleksandar Mihajlovski
Ahmet Jasharevski
Ace Kocevski
Biljana Gerasimovska-Kitanovska
Dilbera Kamberovska
Dragi Zmijanac
Dragi Kostadinovski
Dushica Perishiq
Dushan Shurbanovski
Gjoko Gjorgeski
Gjuner Ismail
Zejnulla Fazliu
Ivan Tulevski
Kelmend Zajazi
Marija Stambolieva
Mersel Xheladini
Mihail Cekov
Muhamed Toçi
Nafi Saraçini
Ratko Lazarevski
Ruska Miceva
Teuta Krashnica-Çučkova

:: KËSHILLI DREJTUES ::

Në pajtim me Statutin e ri u vendos organi i ri për udhëheqje të përditshme - Bordi i drejtorëve, të cilin e përbëjnë Sasho Klekovski, Drejtor i parë ekzekutiv dhe Aleksandar Kërzhhalovski, si u.d. Drejtor ekzekutiv.

1. **Natasha Gaber - Damjanovska**, kryesuese, doktor ish-kencave politike, bashkëpunëtore e lartë në Institutin për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Juridike
2. **prifti Dragi Kostadinovski**, zëvendës-kryesues, zëvendës arkieri dhe sekretar i përgjithshëm i "Mllosrdie", agjenci e Kishës Ortodokse Maqedonase
3. **Andon Markovski**, sekretar i Lidhjes së Pensionistëve të Maqedonisë
4. **Behixhudin Shehapi**, kryetar i El Hilal, Shkup
5. **Biljana Gerasimovska-Kitanovska**, doktor i mjekësisë së përgjithshme, magjistër i neurologjisë, e punësuar në Qendrën Klinike Shkup, kryetare e ESE-Shkup
6. **Zejnulla efendi Fazliu**, Imam
7. **Mihail Cekov**, prift në Kishën Ungjillore-Methodiste në Strumicë
8. **Muhamed Toçi**, i papunësuar, anëtar i Kryesisë së HDZR "Meseçina"
9. **Sveto Stefanovski**, gazetar, kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i revistës "Ekologjia"

:: ZYRA EKZEKUTIVE ::

Në fund të vitit 2008 MCMS kishte 27 bashkëpunëtorë.

Drejtor i parë ekzekutiv

Sasho Klekovski
skl@mcms.org.mk

Drejtor ekzekutiv

Aleksandar Kërzhallovski
akr@mcms.org.mk

Grupi për zhvillim

Dimçe Mitreski
dmt@mcms.org.mk

Miodrag Koliq
mkl@mcms.org.mk

Grupi për punësim

Tetjana Llazarevska
tlz@mcms.org.mk

Llazar Nedanovski
lnd@mcms.org.mk

Gligor Mihailovski
gmh@mcms.org.mk

Lirim Hajredini
lhj@mcms.org.mk

Afrodita Musliu

Grupi për shoqëri civile

Sunçica Sazdovska
ssz@mcms.org.mk

Fatmir Bytyqi
fbt@mcms.org.mk

Emina Nuredinoska
enr@mcms.org.mk

Valentina Çiçeva
vch@mcms.org.mk

Daniela Stojanova
dsj@mcms.org.mk

Krenar Kuka
kkk@mcms.org.mk

Grupi për informata

Gonce Jakovleska
gjk@mcms.org.mk

Gramoz Shabani
gsb@mcms.org.mk

Adis Rahiq
arh@mcms.org.mk

Boris Ristovski
brs@mcms.org.mk

Suzan Shaqir Sulejmani

Balkani dhe marrëdhëniet me bashkësitë

Tanja Hafner Ademi
thf@mcms.org.mk

Dervisha Haxhiq-Rahiq
dhd@mcms.org.mk

Zdenka Videnova

Grupi administrativ

Milka Bozhinovska-Miova
mmv@mcms.org.mk

Mirjana Kunovska
mkn@mcms.org.mk

Biljana Vuçureviq

Danilo Mitov
dmv@mcms.org.mk

Vesna Bogdanovska
vbg@mcms.org.mk



Mendimi i pavarur i revizorëve

Deloitte.

Deloitte DOO
Mit. Teodosij Gologanov 28
1000 Skopje
Republic of Macedonia

Tel: +389 (2) 3111 300
Fax: +389 (2) 3119 544
cemkmacedonia@deloittece.com
www.deloitte.com/mk

Central Register of RM
Registry Number 4881427
Komerzialna Banka AD, Kej Dimitar Vlahov, Skopje
Account no. 300-000000910-22
VAT MK 4030994253680

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИТЕ РЕВИЗОРИ

До Советот на Македонски центар за меѓународна соработка

Извршивме ревизија на приложените финансиските извештаи (стр. 3 до 28) на Македонски центар за меѓународна соработка (во понатамошниот текст "МЦМС"), кои се состојат од билансот на состојба на ден 31 декември 2008 година и билансот на приходи и расходи, извештајот за промените во главнината и извештајот за парични текови за годината што тогаш завршува и преглед на значајни сметководствени политики и останати белешки кон финансиските извештаи.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување. Оваа одговорност вклучува: дизајнирање, имплементирање и одржување на интерна контрола која што е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали истото е резултат на измама или грешка, избирање и примена на соодветни сметководствени политики, како и правење на сметководствени проценки кои што се разумни во дадените околности.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја извршивме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија. Овие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања, да ја планираме и извршиме ревизијата на начин кој ќе ни овозможи да добиеме разумно уверување дека финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.


Ревизијата вклучува спроведување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од значајно погрешно прикажување во финансиските извештаи, настанато како резултат на измама или грешка. При проценувањето на овие ризици, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на МЦМС со цел дизајнирање на ревизорски постапки коишто се соодветни на околностите, но не за цел на изразување на мислење за ефективност на интерната контрола на МЦМС. Ревизијата исто така вклучува и оценка за соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Веруваме дека ревизорските докази кои што ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според наше мислење финансиските извештаи ја прикажуваат реално и објективно, во сите материјални аспекти, финансиската состојба на Македонски центар за меѓународна соработка на ден 31 декември 2008 година, како и резултатите од работењето, промените во главнината и паричните текови за годината што тогаш завршува во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување.

Дилоит ДОО



Лидија Нануш
Директор

Скопје
6 март 2009 година



Јовица Стојчевски
Овластен ревизор

Raporti financiar 2008

BILANC I KONSOLIDUAR I GJENDJES MË 31 DHJETOR 2008

(në mijëra denarë maqedonas, 1EUR = 61.4123 denarë)

Përshkrimi	Vërejtje	2008	2007
A. MJETE			
Mjete jo rrjedhëse			
Patundshmëri dhe pajisje	12	14,907	14,533
Depozitë afatgjatë	13	7,662	8,933
Investime afatgjatë	14	350	350
Gjithsej mjete jo rrjedhëse		22,919	23,816
Mjete rrjedhëse			
Huazime afatshkurte	15	16,700	32,800
Kërkesa nga blerësit dhe Kërkesa të tjera	16	12,136	20,833
Të holla dhe ekuivalent në të tholla	17	75,365	43,730
Gjithsej mjete rrjedhëse		104,201	97,363
GJITHSEJ MJETE		127,120	121,179
B. KAPITALI DHE OBLIGIMET			
Kapitali			
Fondet	18	106,132	103,592
Teprica (të ardhurat mbi shpenzimet)/ Të ardhurat mbi shpenzimet	18	(6,383)	2,540
Gjithsej kapital		99,749	106,132
Obligime jo rrjedhëse			
Rezervime për dobi të punësuarve dhe çmime jubilarë		342	208
Obligime rrjedhëse			
Obligime ndaj furnizuesve dhe Obligime tjera	19	2,250	3,645
Të ardhura të anuluar	20	18,081	9,000
Shpenzime të llogaritura	21	6,698	2,194
Gjithsej mjete rrjedhëse		27,029	14,839
GJITHSEJ KAPITAL DHE OBLIGIME		121,120	121,179

**BILANC I KONSOLIDUAR I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR PERIUHDHËN QË PËRFUNDOI MË 31 DHJETOR 2008**
(në mijëra denarë, 1EUR = 61.4123 denarë)

Përshkrimi	Vërejtje	2008	2007
A. TË ARDHURA			
Donacione dhe grante	16		
Servisi Zhvillimor Kishtar (EED), Gjermani		17,209	16,218
Asociacioni Norvegjez i Komunave (KS)		9,000	603
Polio plus		4,807	0
Sokotab dhe partnerët, Zvicër		4,607	3,599
Ndihma Kishtare Daneze (DCA)		2,768	13,395
Ndihma Kishtare Norvegjeze (NCA)		2,814	4,199
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)		1,923	0
Donatorë të tjerë		1,822	25,241
GJITHSEJ DONACIONE DHE GRANTE		44,951	63,255
Të ardhura vetanake	17		
Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP)		7,429	6,404
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)		4,464	5,127
Asociacioni i Konsultantëve Ekonomik (ECA), B. Madhe		2,034	0
Të ardhura tjera vetanake		2,482	11,805
Gjithsej të ardhura vetanake		16,408	23,336
Kamata dhe dallime pozitive të kursit	18	3,056	4,801
Të ardhura të jashtëzakonshme	19	4,424	8,659
GJITHSEJ TË ARDHURA	20	68,839	100,051
B. SHPENZIME			
Dobrotvorni rashodi			
Shpenzime bamirëse			
Projekte për modernizimin e arsimit (PMO)	21	4,310	4,541
Udhëheqja me MRFP	22	210	184
Maqedonia pa diskriminim (MBD)	23	8,925	8,301
Zhvillimi lokal i bashkësive (LRZ)	24	6,280	2,815
Furnizimi me ujë i komunës së Jegunovcit (VOJ)	25	6,129	8,581
Udhëheqja e mirë (DUM)	26	380	0
Zhvillimi institucional i shoqërisë civile (IGO)	27	1,000	15,116
Forcimi organizativ i aktorëve të shoqërisë civile (ORR)	28	2,271	7,238
Udhëheqja me Rrjetin Ballkanik për OQ (RBM)	29	703	4,272
Bashkëpunimi ndërreligjioz në Maqedoni (MSM)	30	3,035	6,265
Fushata për mobilizimin e resurseve (KMF)	31	3,182	2,197
Programet nga vitet e kaluara (RMS)	32	945	0
Gjithsej shpenzime bamirëse		37,370	60,668
Shpenzime operative			
Rroga dhe kompensime për personelin	33	20,352	19,304
Shpenzime tjera operative	34	16,282	16,407
Informata dhe publikime	35	885	1,008
Gjithsej shpenzime operative		37,519	36,719
GJITHSEJ SHPENZIME	36	74,888	97,440
BILANC para tatimit		-6,050	2,611
Tatimi		-368	-71
BILANCI		-6,418	2,540



Botues

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar

Adresa e botuesit

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar

rr. „Nikolla Parapunov” p.n.,

F.P. 55, 1060 Shkup

Republika e Maqedonisë

Tel.: 02/3065-381;

faksi: 02/3065-298

mcms@mcms.org.mk

www.mcms.org.mk

Drejtor i parë ekzekutiv

Sasho Klekovski

Drejtor ekzekutiv

Aleksandar Kërzhallovski

Redaktor përgjegjës

Gonce Jakovleska

Ndihmës redaktor përgjegjës

Gramoz Shabani

Fotografitë

Foto arkivi i MCSM

Dizajni

Koma lab.

